



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:054741
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05478908

C.nr.355/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Fëllanza Knushaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses .(B...) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B.A., nga fshati ... komuna Mitrovicë, për rimbursim dëmi, vlera e objektit të kontestit 380.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e evidentuar me numër C.nr. 355/20, e datës 19.05.2020 e paditëses .. (...S) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B.A., nga fshati ... komuna Mitrovicë, me bazë juridike rimbursim i dëmit, vlera e objektit të kontestit 380.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 19.05.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurit B.A nga fshati ... komuna Mitrovicë, me bazë juridike rimbursim i dëmit, vlera e objektit të kontestit 380.00 euro.

Gjykata për herën e tretë përmes Aktvendimit C.nr.355/20, të datës 19.07.2023, ka obliguar paditësin që brenda afati prej tre ditësh të plotësoi padinë, përkatësisht të gjej adresën e saktë të të paditurit, nën paralajmërim të pasojave ligjore, kjo pasi që gjykata nuk ka arritur që të paditurit të i dërgoj Aktvendimin për përgjigje në pasi, për shkak të adresës së pasaktë të të njëjtit. Mirëpo paditësi nuk ka plotësuar padinë siç është obliguar nga gjykata.

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 3 të LPK-së, ku është paraparë se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”, dhe

duke marrë parasysh faktin se as pas vendimit të dërguar nga gjykata nuk është plotësuar padia brenda afatit të përcaktuar, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.355/20, datë 20.03.2024

Gjyqtarja
Fëllanza Knushaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.